

THIRRJE PUBLIKE PËR ZHVILLIMIN E UEBFAQES ZYRTARE TË LOJËRAVE MESDHETARE PRISHTINA 2030

Komiteti Organizativ i Lojërave Mesdhetare (OCMG) “Prishtina 2030”, shpall thirrje publike për kompani të specializuara në zhvillimin e teknologjisë së informacionit, për krijimin e uebfaqes zyrtare të Lojërave Mesdhetare “Prishtina 2030”.

1. Qëllimi:

Të krijohet një platformë moderne, funksionale dhe shumëgjuhëshe, që do të shërbejë si burim zyrtar informacioni dhe si mjet promovues i LM Prishtina 2030, duke ofruar qasje të lehtë për publikun vendor dhe ndërkombëtar.

2. Kërkesat kryesore teknike dhe funksionale:

- Dizajn modern dhe në harmoni me identitetin vizual të Lojërave Mesdhetare “Prishtina 2030” (Propozimi të dorëzohet me logon e kandidatures ekzistuese);
- Përmbajtje shumëgjuhëshe (shqip, anglisht dhe frengjisht);
- Strukturë e detajuar për sportet, garuesit, oraret dhe lokacionet e garave;
- Seksion për lajme, njoftime, galeri foto/video dhe media;
- Integrim me rrjetet sociale dhe aplikacione mobile;
- Platformë e sigurt, e shpejtë dhe e optimizuar për përdorim në desktop dhe pajisje mobile;
- Modul e-commerce për shitjen online të biletave, produkteve zyrtare dhe shërbimeve të tjera të lidhura me ngjarjen;
- Panel administrativ i lehtë për përdorim, për menaxhimin e përmbajtjes dhe të transaksioneve online;
- Mirëmbajtjen e uebfaqes.

3. Kush mund të konkurojë:

Të drejtë konkurimi kanë të gjitha kompanitë e specializuara në ofrimin e shërbimeve të uebfaqeve. Aplikuesit duhet të jenë nga Kosova dhe të kenë të paktën 5 vite përvojë në dhënie të shërbimeve të uebfaqeve

4. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Portfolio e projekteve;
- Propozimi teknik (arkitektura e faqes, teknologjitë e propozuara, siguria dhe mirëmbajtja)
- Ofertë financiare e detajuar
- Afati i realizimit të projektit
- Dokumente ligjore që dëshmojnë regjistrimin e kompanisë

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i themeluar nga Komiteti Organizativ (OCMG) i LM Prishtina 2030.

5. Kriteret e vlerësimit:

- Kreativiteti i konceptit uebfaqes **50%**
- Oferta financiare **50%**

6. Mënyra e aplikimit:

Oferta duhet të dorëzohet përmes postës elektronike: **application@noc-kosovo.org**

Data e fundit për aplikim: 20 ditë afat aplikimi nga dita e shpalljes së thirrjes publike, respektivisht deri më **18 Tetor, 2025, ora 16:00!**

SHËNIM: Domain i uebfaqes LM Prishtina 2030 tashmë është i siguruar.

** Për çdo informacion shtesë në lidhje me thirrjen na shkruani në **application@noc-kosovo.org***